



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.06, datë 14.01.2022

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË SEANCËS DËGJIMORE NË PROCEDIMIN
DISIPLINOR NË NGARKIM TË MAGJISTRATIT DHE
MAGJISTRATIT**

Bazuar në nenin 138, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 189, pika 1, germa “a” dhe neni 190, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 25, pika 1, të Rregullores “Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve”, të miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2010, me propozimin e Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e datës 07.02.2022, ora 11.00, për zhvillimin e seancës dëgjimore për procedimin disiplinor nr. 3732/33, datë 06.12.2021, filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit _____, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____ dhe magjistratit _____ me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____
2. Ky vendim u njoftohet menjëherë magjistratëve _____ dhe _____ si dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

